



UNIVERSITETI I MJEKESISE, TIRANE





Përmirësim-Vlerësim-Menaxhim

**DJO KRON**



## KONFERENCE KOMBETARE

# Drejt një Menaxhimi më të Mirë të Dhimbjeve Kronike Jo-Onkologjike: Sfida dhe Mundësi në Shërbimin Shëndetësor Parësor



Financuar nga

**Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor**

**Vendi:**

Auditorium Galileo Galilei  
Rruga e Dibrës  
QSUT, Tiranë, Albania

28 Mars

2025

## Të nderuar pjesëmarrës,

Konferenca Kombëtare "Drejt një Menaxhimi më të Mirë të Dhimbjeve Kronike Jo-Onkologjike: Sfida dhe Mundësi në Shërbimin Shëndetësor Parësor" ka si qëllim kryesor përhapjen e rezultateve të projektit "Përmirësimi i Vlerësimit dhe Menaxhimit të Dhimbjeve Kronike Jo-Onkologjike në Shërbimin Shëndetësor Parësor" DJO KRON, shpallur projekt fitues në Programin Kombëtar të Kërkimit dhe Zhvillimit (PKKZH) për Periudhën 2024-2025 nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI). Projekti koordinohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë Tiranë, në bashkëpunim me Qendrën Kërkimore Shkencore për Shëndetin Publik, Fakulteti i Shëndetit, Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali". Projekti ka si qëllim identifikimin e praktikave aktuale të vlerësimit dhe menaxhimit të dhimbjes kronike jo-onkologjike në kujdesin shëndetësor parësor. Objektivi kryesor është përmirësimi i këtyre praktikave përmes rritjes së kapaciteteve të personelit shëndetësor, si mjekë dhe infermierë të familjes, me qëllim rritjen e cilësisë së kujdesit dhe uljen e kostove shëndetësore. Përveç kësaj, konferenca do të jetë një platformë shkencore për të ndarë përvoja dhe praktika të profesionistëve të shëndetit për dhimbjen kronike, ndër të tjera, si: Sëmundjet Kronike, Dhimbja Kronike dhe Inkurajimi i Pacientit për Fuqizimin e Vetë-Menaxhimit, Strategjitë e Edukimit të Pacientëve për Menaxhimin e Dhimbjes Kronike, Dhimbja Kronike dhe Shëndeti Mendor, Empatia dhe Komunikimi në Vlerësimin e Dhimbjeve Kronike, dhe Ndikimi i Dhimbjes Kronike në Cilësinë e Jetës.

Nëpërmjet projektit DJO KRON, konferenca do të jetë një arenë që synon të promovojë afirmimin e njohurive dhe shkëmbimin e përvojave mes profesionistëve të shëndetit, kërkuesve shkencor, studentëve doktorantë, akademikëve, përfaqësuesve të sistemit shëndetësor dhe pacientëve, mbi menaxhimin e dhimbjes kronike jo-onkologjike, një problem i rëndësishëm aktual i shëndetit publik. Nëpërmjet qasjes së bashkë-krijimit, do të jetë njëkohësisht një event shkencor dhe një laborator i gjallë, ku mund të gjenerohen ide të reja dhe qasje inovative për vlerësimin dhe menaxhimin e dhimbjes kronike.

Nëse jeni të interesuar për të marrë pjesë, shprehni interesin tuaj përmes aplikimit të një abstrakti në tematikën shkencore që përputhet më shumë me interesat tuaja. Gjithashtu, ju keni mundësi të jeni pjesëmarrës pasiv në konferencë, duke rritur kapacitetet dhe njohuritë tuaja përmes edukimit në vazhdim që konferenca mundëson.

Konferenca do të ketë prezantime orale dhe sesione e-poster.

Ndaj, mos hezitoni të jeni pjesë e Konferencës Kombëtare 2025, DJO KRON, për të shkëmbyer njohuri me kolegët dhe për t'u përditësuar me të rejat më të fundit shkencore në lidhje me Vlerësimin dhe Menaxhimin e Dhimbjeve Kronike Jo-Onkologjike në Shërbimin Shëndetësor Parësor dhe jo vetëm.

Ju mirëpresim në kryeqytetin e Shqipërisë, Tiranë!



Përmirësim-Vlerësim-Menaxhin

**DJO KRON**

# Rreth Eventit

Konferenca Kombëtare DJO KRON 2025 "Drejt një Menaxhimi më të Mirë të Dhimbjeve Kronike Jo-Onkologjike: Sfida dhe Mundësi në Shërbimin Shëndetësor Parësor", ofron mundësi për të gjithë profesionistët e shëndetit të njihen me praktikat aktuale të vlerësimit dhe menaxhimit të dhimbjes kronike jo onkologjike në shërbimin shëndetësor parësor.

Konferenca ofron njëkohësisht një mundësi për rrjetëzim në fushën e vlerësimit, menaxhimit dhe trajtimit të dhimbjes kronike nga prespektiva të ndryshme ekspertize, përvojash dhe qasje multidisiplinare.

Dhimbja kronike jo-onkologjike është një problem i rëndësishëm që ka ndikim të madh te pacientët, sistemet shëndetësore dhe shoqëria. Njohja e rëndësisë së saj në kujdesin parësor është e domosdoshme për të zhvilluar strategji efektive për menaxhimin e saj dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës së pacientëve.

Konferenca Kombëtare 2025 DJO KRON do të jetë një forum kombëtar shkencor i dhimbjes kronike për të promovuar afirmimin dhe përhapjen e njohurive dhe shkëmbimin e ideve të reja ndërmjet profesionistëve shëndetësor të fushave të ndryshme, profesorët, shkencëtarët dhe studentët dhe përfaqësuesit e institucioneve shëndetësore.

Shfrytëzoni këtë mundësi për t'u bashkuar me ne kryeqytetin e Shqipërisë, Tiranë.



Përmirësim-Vlerësim-Menaxhin

**DJO KRON**

# Kush duhet të marrë pjesë?

**Kjo konferencë është një mundësi e shkëlqyer për të shkëmbyer përvoja, njohuri dhe ide për të përmirësuar trajtimin e dhimbjes kronike dhe cilësinë e jetës së pacientëve.**

**Profesionalistët e Shëndetit** – Mjekë, infermierë, fizioterapistë, dhe çdo profesionist tjetër që merret me menaxhimin dhe trajtimin e dhimbjes kronike jo-onkologjike.

**Ekspertë dhe Specialistë në Fushën e Dhimbjes Kronike** – Ata që kanë përvojë dhe njohuri në vlerësimin dhe menaxhimin e dhimbjeve kronike, të cilët mund të kontribuojnë në diskutime multidisiplinare.

**Profesorë dhe Shkencëtarë** – Ata që janë të angazhuar në kërkime dhe zhvillimin e metodave të reja për trajtimin e dhimbjeve kronike dhe kanë interesa akademike në këtë fushë.

**Studentë të Shkencave Shëndetësore** – Ata që studiojnë në fushat e mjekësisë, infermieristikës, fizioterapisë, dhe disiplina të tjera shëndetësore, dhe duan të zgjerojnë njohuritë e tyre në këtë fushë.

**Përfaqësues të Institucioneve Shëndetësore** – Ata që punojnë në nivelin institucional dhe janë të angazhuar në zhvillimin e politikave shëndetësore dhe strategjive për menaxhimin e dhimbjes kronike në shërbimin shëndetësor parësor.

**Komuniteti i pacientëve me sëmundje kronike** – Nëpërmjet qasjes së bashkrijimit synohet që pacientët me dhimbje kronike të jenë pjesë aktive e strategjive të vlerësimit dhe menaxhimit të dhimbjes nëpërmjet ndarjes së përvojave dhe sugjerimeve të tyre.



Përmirësim-Vlerësim-Menaxhin

**DJO KRON**



- Projekti DJO KRON, qasja, arritjet, sfidat dhe implikime për praktikën e kujdesit shëndetësor
- Sëmundjet Kronike, dhimbja kronike dhe inkurajimi i pacientit për fuqizimim të vetë-menaxhimit
- Strategjitë e Edukimit të Pacientëve për Menaxhimin e Dhimbjes Kronike
- Mjetet e Vlerësimit të Dhimbjes: Praktikrat më të mira për Profesionistët e Shëndetit
- Dhimbja kronike dhe shëndeti mendor: Qasje ndaj kujdesit të integruar
- Empatia dhe Komunikimi në Vlerësimin e Dhimbjeve Kronike
- Ndikimi i dhimbjes kronike në cilësinë e jetës
- Përdorimi i mjeteve dixhitale për monitorimin e dhimbjes kronike në praktikën klinike
- Ndërhryjet për menaxhimin efektiv të dhimbjes kronike-Praktikat më të mira për profesionistët e kujdesit shëndetësor
- Qasje jo-farmakologjike për lehtësimin e dhimbjes kronike në praktikën klinike
- Vlerësimi infermieror i dhimbjes në popullatat e cënueshme (p.sh., të moshuar, pediatri)
- Aderimi i mjekimit në vetë-kujdesin dhe menaxhimin e dhimbjes kronike
- Praktikrat inovative të kujdesit shëndetësor në menaxhimin e dhimbjes kronike dhe mbrojtjen e pacientit
- Dhimbja kronike dhe çrregullime të gjumit: Ndërhryjet e Infermierisë



Përmirësim-Vlerësim-Menaxhin

**DJO KRON**





# Grupi i Punës-Projekti PKZH (AKKSHI)



**Prof. Asoc. Dr. Enkeleda SINAJ**

(Kordinatore e projektit)

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë Tiranë



**Prof. Dr. Ilirjana ZEKJA**

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë Tiranë




**Prof. Asoc. Dr. Vjollca NDREU**

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë Tiranë



**Dr. Glodiana Sinanaj**

Qendra Kërkimore Shkencore për Shëndetin Publik,  
Fakulteti i Shëndetit, Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali"



**Prof. Asoc. Dr. Fatjona Kamberi**

Qendra Kërkimore Shkencore për Shëndetin Publik,  
Fakulteti i Shëndetit, Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali"



**Phd candidate Jerina Jaho**

Qendra Kërkimore Shkencore për Shëndetin Publik,  
Fakulteti i Shëndetit, Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali"



**Z. Fatjon ELEZAJ**

(Specialist IT)

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë Tiranë



**Znj. Marigo JAUPI**

(Financiare)

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë Tiranë



**Znj. Dhurata ISLAMBEJO**

(Juriste)

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë Tiranë

# Data të rëndësishme

Data e Konferencës	Mars 28, 2025
Hapet Dërgimi i Abstrakteve	1 Shkurt 2025
Regjistrimi Pjesëmarrje Pasive	1 Shkurt 2025
Afati i Dërgimit të Abstrakteve	20 Shkurt 2025
Regjistrimi Përfundimtar	28 Mars 2025
Pjesëmarrje aktive dhe pasive	Falas

# Kontakte të rëndësishme

Për Dërgimin e Abstrakteve:

[enkeleda.sinaj@umed.edu.al](mailto:enkeleda.sinaj@umed.edu.al)

[fatjona.kamberi@univlora.edu.al](mailto:fatjona.kamberi@univlora.edu.al)

Për Regjistrim pasiv:

[vjollca.ndreu@umed.edu.al](mailto:vjollca.ndreu@umed.edu.al)

Vendi:

**Auditorium Galileo Galilei  
Rruga e Dibrës  
QSUT, Tiranë, Albania**

<https://www.visit-tirana.com/plan-your-stay/tirana-map/>

Konferenca do të akreditohet nga ASCK. <https://asck.gov.al/>



Përmirësim-vlerësim-Menaxhim

**DJO KRON**

# Udhëzime për Dërgimin e Abstrakteve

## Llojet e Dërgimit:

### Sesionet Orale

Këto seanca të drejtpërdrejta, ballë për ballë, janë rreth 10 minuta, të pasuara nga një periudhë pyetjesh.

### Sesionet E-Poster

E-Posterat do të shfaqen në format digjital dhe do të prezentohen në kohë reale, të shoqëruara me një periudhë pyetjesh gjatë pushimeve të konferencës.

## Përmbledhje:

- Konferenca Kombëtare 2025 do të jetë një konferencë fizike; autorët duhet të marrin pjesë dhe të prezantojnë personalisht punimet e tyre në konferencë.
- Punimet mund të kenë disa autorë; të paktën një autor duhet të regjistrohet dhe të marrë pjesë në konferencë.
- Autori që dërgon abstraktin për aplikim duhet të vendos të gjitha të dhënat e autorëve.
- Email-i i autorit korrespondent do të jetë personi i kontaktit.
- Të gjitha abstraktet duhet të dërgohen në shqip dhe në anglisht.
- Të gjitha abstraktet do të shqyrtohen në mënyrë të pavaruar për cilësinë e përmbajtjes së tyre edukative/teorike/ kërkimore, përputhshmërinë me udhëzimet e dërgimit dhe lidhjen me temën e konferencës.
- Abstraktet duhet të përdorin font me madhësi 12 dhe në përputhje me Udhëzimet për Abstraktet e Prezantimit Oral dhe E-poster

## Të gjitha abstraktet e dërguara duhet të:

- Të jenë të shkruara në shqip dhe anglisht.
- Të kenë një numër fjalësh prej **350 fjalë ose më pak** (përfshijë titullin dhe fjalët kyçe).
- Të përfshijnë një titull me **maksimum 12 fjalë**.
- Të përfshijnë **pesë fjalë kyçe**.
- Të tregohet qartë nëse aplikimi është **për prezantim oral** apo **E-poster**.

## Përdorni seksionet e mëposhtme:

- Hyrje, përfshirë Qëllimin
- Metodat
- Rezultatet
- Konkluzione dhe Rekomandime



# Vendi i Organizimit të Konferencës

Tiranë, Albania


<https://www.visit-tirana.com/plan-your-stay/tirana-map/>

## Kontakti në:

### Koordinatorët e Konferencës:

Prof. Asoc. Enkeleda Sinaj  
[enkeleda.sinaj@umed.edu.al](mailto:enkeleda.sinaj@umed.edu.al)

Prof. Asoc. Fatjona Kamberi  
[fatjona.kamberi@univlora.edu.al](mailto:fatjona.kamberi@univlora.edu.al)



# SHENO DATEN NE KALENDAR

## 28 Mars 2025

Eja të krijomë ura bashkëpunimi për menaxhimin më të mirë të dhimbjes kronike dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.

Bëhuni pjesë e momenteve të paharrueshme që nuk do të donit t'i humbisnit.



Përmirësim-Vlerësim-Menaxhim

**DJO KRON**